



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 98, Datë 30.04.2018

MBI

**MIRATIMIN E KONTRATËS PËR SHIT-BLERJEN E SASISË SË TEPËRT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE QË REZULTON PAS PËRMBUSHJES SË KËRKESËS SË
KLIENTËVE QË PËRFITOJNË NGA SHËRBIMI UNIVERSAL, ME QËLLIM
MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETIN E SHPËRNDARJES PËR PERIUDHËN
KOHORE 01.01.2018-31.12.2018".**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike"; nenit 5 të VKM nr. 244 dt.30.03.2016, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, që ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", i ndryshuar dhe nenit 26 të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016, bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 30.04.2018, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike të ERE për miratimin e kontratës Tip për shit-bletjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2018 – 31.12.2018,

Konstatoi se:

- Shoqëria "OSHEE sh.a." me shkresën nr. 3998/1 Prot, datë 06.03.2018, ka përcjellë në ERE draftin e "Kontratës për shit – bletjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2018-31.12.2018".
- Në datë 07.03.2018, u depozitua në ERE shkresa e shoqërisë KESH sh.a. me nr.1017/3 datë 07.03.2018 dhe nr. 186/7 Prot. datë 07.03.2018 të ERE me draft Kontratën për shit – bletjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2018-31.12.2018".
- KESH sh.a. bën me dije se pavarësisht diskutimeve për të arritur në një draft të dakortësuar të kësaj kontrate, ka patur dispozita të saj të cilat nuk kanë gjetur dakortësinë e Palëve.
- Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.03.2016, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit,

transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", ndryshuar me VKM nr. 729, datë 08.12.2017 përcaktohet se: Kontrata ndërmjet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe prodhuesit të energjisë elektrike miratohet nga ERE.

- Me vendimin nr. 56, datë 09.03.2018, Bordi i ERE vendosi "Mbi fillimin e procedurës për miratimin e draft – "kontratës tip për shit-blerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2018 – 31.12.2018".
- Në vijim të konstatimeve sa më sipër, në datë 30.03.2018, ERE organizoi një seance dëgjimore me palët e interesit, ku nuk mungoi përfaqësimi nga KESH sh.a dhe OSHEE sh.a, si dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoritetit të Konkurrencës.
- Në seancë përfaqësuesit e KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. bënë me dije se kanë gjetur dakortësinë në lidhje me përmbajtjen e nenit 4, dhe me shkresën nr. 7195/1 Prot., datë 26.04.2018, OSHEE sh.a ka përcjellë në ERE draft -kontratën për shit – blerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2018 - 31.12.2018, me propozimin e saj final.
- Nga shqyrtimi i propozimeve të sjella nga palët në lidhje me përmbajtjen e nenit 4 të kësaj kontrate, konstatohet se sa parashikuar në përmbajtjen e këtij Vendorsja e një afati me tolerant, prej 10 ditësh për paraqitjen e faturës u vensos në referencë të marrëveshjesve dhe kontratave të tjera të ngjashme.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi :

1. Të miratojë kontratën për shit – blerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2018 - 31.12.2018.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a, KESH sh.a, OST sh.a, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoritetin e Konkurrencës, për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 Janar 2018.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet Ankim në Gjykatën Administrative brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare .

KRYETARI

Petrit AHMETI